



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORT MONITORIMI, GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË, TIRANË, 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Hyrje	03
Organigrama	04
Buxheti	05
Të ardhurat e gjykatës	06
Prokurimet	07
Kosto për një çështje	07
Stoku	08
Transparenca	09
Gjetje dhe përfundime	09
Rekomandime	10
Bibliografia	11

Hyrje

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nisi funksionimin e saj që në vitin 2013 dhe nëpërmjet hartës së re gjyqësore mori kompetencat e gjykatës administrative që funksiononin në Korçë, Durrës, Shkodër dhe Tiranë. Në të njëjtën kohë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Lushnjë mori kompetencat e gjykatave administrative në Vlorë dhe Gjirokastrë.

Gjykatat Administrative kanë vendimmarrje gjyqësore në lidhje me mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i akteve administrative individuale, akteve nënligjore normative (kjo kompetencë i takon Gjykatës Administrative të Apelit) dhe kontratave administrative, mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik, mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative, në rastet e parashikuara në ligj, mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike si dhe gjykimet për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative që dënohen me heqje lirie deri në 30 ditë apo kërkesat për zëvendësimin e këtij dënimi.


Para vitit 2013, gjykimi administrativ zhvillohej në seksionet administrative të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, seksione të cilat nuk ishin të ngritura në çdo Gjykatë.

Organigrama

Numri i përgjithshëm i punonjësve i miratuar nga KLGJ për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë është 99 punonjës.

Në organikë përfshihen 27 gjyqtarë, 27 sekretarë gjyqësorë, 2 kryesekretarë dhe pjesa tjetër e janë punonjës me funksione të strukturave të shërbimeve administrative dhe mbështetëse.

Përgjatë vitit 2024 numri faktit i gjyqtarëve ka pësuar ndryshime për shkak të pezullimit nga detyra, rikthimit në detyrë apo delegimit të disa gjyqtarëve. Aktualisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë [1]. Ndërsa numri total i punonjësve gjatë vitit 2024 ishte 85.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë edhe pas riorganizimit vijon ta ushtrojë veprimtarinë e saj në mesin e ekzistuese, infrastruktura e së cilës nuk është në përputhje me strukturën organizative [2].

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka në organikë 3 specialistë dhe është përgjegjëse për përgatitjen e projekt-buxhetit të gjykatës, monitorimin e shpenzimeve buxhetore, kryerjen e pagesave dhe çdo transaksioni financiar të parashikuar nga buxheti, si dhe për administrimin e vlerave materiale dhe monetare sipas ligjit.

[1] Raporti vjetor i GJASHP, Tiranë, 2024 f.2

[2] Po aty.

Drejtori i drejtorisë, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Gjykatës, është përgjegjës dhe i raporton Këshillit të Gjykatës/Kryetarit/Kancelarit.

Gjatë vitit 2024, për shkak të mungesës së Kancelarit të Gjykatës vitet e fundit, është komanduar si anëtare e këshillit të gjykatës, një nëpunëse civile nga KLGJ. Funksionet e kancelarit i kanë kaluar përgjithësisht K/sekretares së Gjykatës nën mbikqyrjen e Zv/Kryetarit.

Të gjithë gjykatësit paguhën sipas nivelit G1 të pagave.

Buxheti [3]

Buxheti i gjykatës për vitin 2024 ishte 231,630,000 lekë. Me ndryshimet e kryera gjatë vitit buxheti arriti në 244,150,000 lekë. Shpenzimet faktike ishin 227,130, 479 lekë ndërsa realizimi i buxhetit është 93%.

Buxheti total për vitin 2023 ishte 213,708,000 lekë.

Nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në zërin paga dhe sigurime është akorduar fondi total 190 100 000 lekë, i cili është realizuar në masën 185 979 498 lekë ose 98%. Ky fond është i rishikuar gjatë vitit për shkak të tepricave të fondeve në lidhje me mosplotësimin e organikës (shih më sipër, organigrama f.1).

Gjatë vitit 2024, janë shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me diferencën e pagave të gjyqtarëve të kësaj gjykate për periudhën 01.01.2019 – 08.01.2023 si dhe pagesa e diferencave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që lindën si rezultat i reflektimit në sistemin e tatimeve të pagës së re të gjyqtarit.

Në zërin shpenzime operative për vitin 2024, nga buxheti i shtetit, është akorduar fondi total i rishikuar përgjatë vitit në masën 41 500 000 lekë, i cili është realizuar në vlerën 40,910,983 lekë ose në masën 99%. Ky fond ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit me materiale e shërbime zyre, shpenzime për dieta. Gjithashtu janë kryer likuidimet e shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, posta, shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme dhe vendime gjyqësore [4].

[3] Shënim: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ushtron detyrat e saj referuar përcaktimeve në nenin 41/b, të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku sipas nenit 45 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se "Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar", i ndryshuar, në aktet në zbatim të tyre si dhe në Vendimin e KLGJ nr. 148 datë 29.03.2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi".

[4] Raporti vjetor i GJASHP, Tiranë f.25

Buxheti në zërin e kapitaleve të trupëzuara është planifikuar e rishikuar më pas në shumën 12 310 000 lekë [5]. Kjo vlerë është miratuar për rikonstruksionin dhe standardizimin e dhomës së serverit. Procedura për këtë zë të prokurimeve është kryer, por objekti nuk është marrë në dorëzim nga komisioni përkatës duke mos u kryer likuidimi.

Përsa i përket shpenzimeve operative dhe investimeve që ka kryer gjykata gjatë vitit 2024, kanë qenë në normalitet dhe kanë ecur progresivisht me fluksin e punës dhe numrin e çështjeve të gjykuara.

Edhe pse kishte rritje të buxhetit në shpenzime kapitale për vitin 2024, gjykata nuk ka ende kushte pune normale.

Të ardhurat e gjykatës

Të ardhura e gjykatës janë krijuar në formën e tarifave të padive dhe mbi aktet si dhe shërbimet gjyqësore për vitin 2024 ndërsa arrijnë vlerën prej 83 052 898 lekë, ose 1/3 e buxhetit vjetor për gjykatën.

Nga këto arkëtime Gjykata përfiton 10% të kësaj shume ndërkohë që ka përfituar me anë të rritjes së autorizuar vlerën prej 7 621 858 lekë, ose 92 % të të ardhurave që i takonin ligjërisht për vitin 2024 [6].

Shuma prej 683 431 lekë ose 8% e të ardhurave, nuk i ka kaluar Gjykatës por si rrjedhojë ka kaluar në buxhetin e shtetit, pasi gjatë muajit dhjetor 2024 nuk është kryer rritje e autorizuar për efekt të fund vitit.

Të ardhurat, janë përdorur përkatësisht në vlerën 4 154 223 lekë për shpenzime operative dhe 809 268 lekë për investime, gjithsej në masën 65% të fondit të krijuar. Diferenca e të ardhurave të krijuara në masën 2 658 367 lekë është derdhur në Buxhetin e Shtetit.

Të ardhurat dytësore për vitin 2023 ishin në masën 61,021,000 milionë lekë. Ndërkaq rritja e autorizuar është 57,033,000 lekë, ku sërish nuk është kryer rritja e autorizuar për shkak të fundit të vitit.

Në vitin 2022 janë mbledhur 85 milionë lekë nga shërbimet në gjykatë ndërkohë buxheti i këtij viti për gjykatën ishte 96 milionë lekë.

Gjatë vitit 2021, janë arkëtuar 103.675.861 lekë.

[5] Raporti vjetor i GJASHP, Tiranë f.25

[6] Ligji nr.9975, 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", neni 11/2; Udhëzimi i Ministrit të Financave "Për përdorimin e të ardhurave të krijuara nga tarifat e shërbimeve të administratës gjyqësore"

Prokurimet

Janë parashikuar 33 procedura prokurimi ndërsa janë realizuar 32 të tilla, Në përgjithësi blerja e shërbimeve është siguruar me një zbritje të vlerës së prokurimit ndërkohë që shërbimet standarde dhe që përsëriten janë marrë në vlerën e prokurimit si për shembull ekspertizat, mirëmbajtje të sistemit kompjuterik, etj.

9 nga prokurimet janë në vlerën e prokurimit ose më pak se 5% diferencë mes vlerës së shpalljes dhe vlerës së prokurimit, 1 prokurim është në trefishin e vlerës së shpalljes (BNT Electronics, printime), ndërsa prokurimet e tjera janë në vlera konkurruese ndonjëherë edhe në gjysmën e vlerës së shpalljes siç janë shërbimet e mirëmbajtjes apo dezinfektimit.

Kosto për një çështje

Numri i çështjeve të parashikuara për tu trajtuar në vitin 2024 ishte 18000 kurse numri i çështjeve të realizuara ishte 14273 çështje. Shpenzimet korente faktike ishin 227,130,479 lekë. Kosto për një çështje gjatë 2024 ishte 15,913 lekë.

Numri i çështjeve të parashikuara për tu trajtuar në vitin 2023 ishte 15000 por sasia faktike e çështjeve të shqyrtuara ishte 15977 ndërsa fondi faktik i shpenzuar tek shpenzimet korente ishte 212,857,000 lekë, kosto për një çështje shkon në 13,310 lekë.

Në vitin 2022 kosto për çështje në gjykatën administrative në Tiranë ishte 10,423 lekë çështje.

Tab: Kosto për çështje në vitet 2022-2024

Viti	Kosto për çështje
2024	15,913 lekë
2023	13,310 lekë
2022	10,423 lekë

Stoku

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, stoku në fund të 2024 ka arritur në 6,646 çështje, duke shënuar një ulje prej 5.2% ose 368 çështje më pak krahasuar me fillimin e vitit.

Gjatë vitit 2024, gjykatat administrative të shkallës së parë kanë regjistruar gjithsej 14,370 çështje të reja, duke shënuar një rënie prej 6.9% krahasuar me vitin paraardhës.

Në vitin 2024, ngarkesa totale e punës në gjykatat administrative të shkallës së parë (Tiranë dhe Lushnjë) ka arritur në 23,158 çështje, duke përfshirë si çështjet e mbartura nga vitet e kaluara ashtu edhe çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranës, si gjykata më e ngarkuar në këtë nivel, përbën 81.2% të totalit të ngarkesës, me 18,823 çështje në shqyrtim.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (WR) në gjykatat administrative të Tiranës për vitin 2024 është 1447.9 çështje.

Tab: Çështje Administrative të regjistruara për gjykim në vitin 2024

Çështje Administrative (Të regjistruara të reja në vitin 2024)	Çështje Administrative (Të mbartura nga 2023)	Total	Të përfunduara në 2024	Të mbartura për 2025
11809	7014	18823	12177	6646

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, secili gjyqtar ka gjykuar mesatarisht 267 çështje më shumë sesa një vit më parë me vlerë 936.7, duke sjellë një rritje prej 40% të treguesit ER.

Norma e Zgjidhjes së Çështjeve në vitin 2024 (CR) është 103.12 % nga 91.24% që ishte në vitin 2023.

Treguesi DT është 199 ditë, duke ulur kohën e nevojshme për evadimin e çështjeve me 18 ditë, krahasuar me vitin 2023 [7].

[7] Raporti vjetor i KLGJ, 2024, f.105

Në dy gjykatat administrative të shkallës së parë në Tiranë dhe Lushnjë, 61% e çështjeve të gjykuara (9,025 raste) janë përfunduar brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të përshtetshëm të shqyrtimit për këtë kategori; 18% e çështjeve (2,653 raste) kanë pasur një kohëzgjatje midis 6 dhe 12 muajsh; 11.3% e çështjeve (1,669 raste) janë përfunduar në një periudhë midis 1 dhe 2 viteve; 9.6% e çështjeve kanë pasur një kohëzgjatje mbi 2 vite, duke treguar se pavarësisht sfidave; ka një prirje të qartë për uljen e kohës së pritjes për shumicën e çështjeve.

Transparenca

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është plotësuar. Gjykata ka pritur gjithsej 12 kërkesa. Secila nga kërkesat është publikuar por ndërkohë nuk janë publikuar përgjigjet në 9 raste ndërsa janë publikuar në mënyrë të përmblendhur në 3 raste.

Të gjitha përgjigjet janë dhënë brenda afatit të parashikuar nga Ligji për të Drejtën e Informimit.

Tek kategoria ‘programi i transparencës’, këndi për buxhetin, nuk është pasqyruar raporti i monitorimit vjetor për vitin 2024 si dhe në kënde të tjera të përshtatshme analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023.

Tek këndi ‘Informacione për procedurat e prokurimit’ janë ngarkuar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitin 2024, lista e kontratave të lidhura.

Tek këndi ‘E drejta për tu informuar dhe ankuar’ janë ngarkuar të dhënat e kordinatorit, emri, telefoni zyrtar, adresa zyrtare e emailit dhe adresa zyrtare e institucionit. Janë ngarkuar formularët e ankesës dhe kërkesës.

Gjetje dhe përfundime

Gjykata administrative në Tiranë me dekret ka 27 gjyqtarë. Aktualisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë. Ndërsa numri total i punonjësve gjatë vitit 2024 ishte 85 nga 99 që janë të parashikuar në strukturë.

Buxheti i gjykatës për vitin 2024 ishte 231,630,000 lekë. Me ndryshimet e kryera gjatë vitit buxheti arriti në 244,150,000 lekë. Shpenzimet faktike ishin 227,130,479 lekë ndërsa realizimi i buxhetit është 93%.

Të ardhura në formën e tarifave të padive dhe mbi aktet si dhe shërbimet gjyqësore arrijnë vlerën prej 83 052 898 lekë ose /3 e buxhetit total të gjykatës. Gjykata përfiton 10% të kësaj shume ndërkohë që ka përfituar me anë të rritjes së autorizuar vlerën prej 7 621 858 lekë, ose 92 % të të ardhurave që i takonin ligjërisht për vitin 2024.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe pas riorganizimit vijon ta ushtrojë veprimtarinë e saj në godinën ekzistuese, infrastruktura e së cilës nuk është në përputhje me strukturën organizative.

Rekomandime

Gjykata duhet të zgjidhë në mënyrë urgjente çështjen e hapësirave për aktivitetin gjyqësor përmes KLGJ.

KLGGJ duhet të plotësojë në mënyrë urgjente organikën e gjyqtarëve të kjo gjykatë si një nga gjykatat me stok të konsiderueshëm të çështjeve të prapambetura.

Shpenzimet e të ardhurave që sigurohen nga shërbimet gjyqësore e tarifat (10 e totalit) duhet të orientohen më shumë drejt rritjes së aksesit të qytetarëve në gjykatë se sa drejt shpenzimeve, duke pasur parasysh edhe sasinë e tyre në raport me buxhetin total, si për shembull lehtësimin e procedurës për pagesat e shërbimeve gjyqësore shoqëruar kjo edhe me propozime për të ulur vlerën e tarifave.

Ministria e Financave të kryejë rritjen e autorizuar për të gjithë vlerën takuese për gjykatën, duke bërë ndryshimet e nevojshme për procedurën që lidhet me muajt e fundit të vitit.

Gjykata duhet të publikojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e buxhetit për vitin në vazhdim. Tabelat duhet të jenë të kuptueshme dhe më një shpjegim të shkurtër rreth tyre. Duhet publikuar raporti vjetor i gjykatës ose analiza vjetore dhe në të njëjtin vend edhe arkivi i analizave vjetore të gjykatës për vitet e mëparshme. E njëjta praktikë duhet të ndiqet për dokumente të tjerë thelbësorë që lidhen me financat dhe buxhetin e gjykatës si raporti i monitorimit vjetor të buxhetit, regjistrat e prokurimeve dhe vendimi i KLGJ për buxhetin e caktuar për gjykatën.

Bibliografia

Legjislacioni dhe Akte Ligjore

- Ligji nr. 9975, 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 11/2; Udhëzimi i Ministrit të Financave “Për përdorimin e të ardhurave të krijuara nga tarifat e shërbimeve të administratës gjyqësore”
- Vendim i KLGJ, Nr. 286, datë 29.05.2023 ‘Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë’
- Vendim i KLGJ nr. 298, datë 30.05.2023 ‘Mbimiramimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë’
- Vendim i KLGJ nr.641, datë 23.12.2020 “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre” (edhe anex)

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Buxheti PBA 2023-2025
- Raporti vjetor i KLGJ për vitin 2024
- Raporti vjetor i ZABGJ për vitin 2023
- Raportet 4 mujore të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve 2024
- Regjistri i realizimit të prokurimeve, 2024
- Rregullore “Per organizimin dhe funksionimin e brendshëm te gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Tirane”

Burime të tjera

- Arjona Firaj, Koordinatore për Median në GJASHP, Tiranë, Koordinatore, Komunikim
- Komunikim me Drejtoreshen e buxhetit dhe financës, Vilma Bodgani